

Dr. Jahja Nasir
Dr. Ebul Nefa Abdul Ahar

**SHKURTIMI I THONJVE NË
DRITËN E SUNNETIT DHE
MJEKËSISË**

Kaçanik, 2006

Përkthyes:

Dr. Musli VËRBANI

Titulli i origjinalit:

تَقْلِيمُ الْأَظْفَارِ فِي ضَوْءِ السُّنَّةِ النَّبَوِيَّةِ وَ الْعِلْمِ الطَّبِئِيِّ

SHKURTIMI I THONJVE NË DRITËN E SUNNETIT DHE MJEKËSISË

Recensent:

Ajni Sinani

Redaktore gjuhësore:

Mimoza Sinani

*Radhitja kompjuterike,
kopertina dhe dizajni grafik*

Mumin Shehu

Prishtinë

2006

Të drejtën e ribotimit e rezervon botuesi

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

1. **Çfarë t'ju jep Pejgamberi, merreni, e çfarë t'ju ndalojë, largohuni prej asaj".**

(EL HASHR: 7)

Ebu Hurejre r.a. transmeton se Muhammedi a.s. ka thënë:

"Pesë gjëra janë natyrshmëri (të njeriut):

1. ***Sunetia (rrethprerja)***
2. ***Pastrimi (të hequrit) i qimeve rreth organeve të turpshme***
3. ***Shkurtimi i thonjve***
4. ***Pastrimi (të hequrit) i qimeve nën sqetulla dhe***
5. ***Shkurtimi i mustaqeve".***

(MUTEFIKUN ALEJHI)

Hyrje

BISMILAHIRR-RAHMANIRR-RAHIM

Paqja dhe përshëndetjet qofshin për pejgamberin e fundit, zotëriun tonë Muhammedin a.s., familjen e tij, shokët e tij dhe të gjithë ata të cilët e pasojnë me sinqeritet deri në Ditën e Gjykimit.

Ky punim përfshin një prej cilësive të përgjithshme të Muhammedit a.s., për të cilën ai ka nxitur vazhdimisht, e kjo cilësi është shkurtimi i thonjve.

Në lidhje me shkurtimin e thonjve ekzistojnë hadithe të vërteta të shumta, pasi që është një prej sunneteve të natyrshmërisë dhe bën pjesë në temën *Mjekësia e Muhammedit a.s.* Pra, tema e cila ka të bëjë me mjekësinë preventive dhe ruajtjen e shëndetit.

Çështja e saj ka të bëjë me pastërtinë, pastrimin e dhëmbëve (përdorimin e misvakut, ose furçës), pastrimin e duarve para ushqimit, etj. etj., të cilat janë prej mësimeve të Islamit në lidhje me edukatën, pastërtinë dhe zbukurimin, të cilat në mjekësinë bashkëkohore quhen preventiva mjekësore, pra mund ta emërojmë me temën *"Mjekësia preventive Islame"*.

LËNDA E STUDIMIT

Kjo lëndë përbëhet prej dy anëve: anës fetare dhe anës mjekësore, dhe kjo prej dy kapitujve:

Kapitulli i parë: Studimi islam në lidhje me shkurtimin e thonjve dhe hadithet që flasin për këtë. Ndalesa e zgjatjes së thonjve me sheriatin islam dhe mendimi islam në lidhje me zbukurimin dhe etikën nëpërmjet shkurtimit të thonjve.

Kapitulli i dytë: Studimet mjekësore tregojnë për dëmet dhe pasojat të cilat shkaktohen për shkak të zgjatjes së thonjve, gjë që është në kundërshtim me natyrshmërinë (ligjin e All-llahut që e ka caktuar natyrshmëri të njeriut). Kjo vepër (zgjatja e thonjve) është në kundërshtim me mësimet islame dhe hadithet e Muhammedit a.s., të cilat janë burimi i dytë i sheriatit islam, menjëherë pas librit të All-llahut – Kur'anit fisnik.

Për këtë arsye kapitulli i parë kryesisht është i përcaktuar në sunnetin e shkurtimit të thonjve në sheriatin islam. Ndërsa, kapitulli i dytë është i përqendruar në dëmet të cilat shkaktohen prej zgjatjes së thonjve në dritën e mjekësisë.

QËLLIMI I KËTIJ STUDIMI

Qëllimet dhe pikësyzimet e këtij studimi që dëshirojmë t'i realizojmë janë:

1. Të përqendruarit e vëmendjes në sunnetet e Pejgamberit s.a.v.s., që kanë të bëjnë me tematika mjekësore, edukative dhe arsimuese, pra në mjekësinë sunnetike të Muhammedit a.s. që duhet ta pranojnë studiuesit muslimanë dhe jomuslimanë. Ajo është burim i Islamit për njohuri dhe arsimim. Kjo dëshmohet me shkencën bashkëkohore nëpërmjet studimeve shkencore të trashëgimisë pejgamberike.

2. Ndërlidhja shkencore ndërmjet fikhut islam, mjekësisë sunnetike të Muhammedit a.s. dhe medicinës bashkëkohore me qëllim që studimi të jetë si model i metodologjisë (akademike) të mjekësisë islame.

3. Ndriçimi i metodave arsimuese islame dhe dobisë prej tyre, dhe kjo në dritën e studimeve të përbashkëta: islame, shkencore dhe politike, për të sqaruar përsosmërinë e arsimit islam. Në etikë bën pjesë edhe shkurtimi i thonjve, që është shëndet për trupin dhe preventivë ndaj sëmundjeve, pamje e jashtme e mirë dhe fisnikëri e njeriut.

Paraqitja e këtij studimi edhe në aspektin fetar, por edhe në atë praktik jep për të kuptuar qartë vizionin e muslimanëve dhe bën që ata t'iu përmbahen kushtimisht mësimëve të fesë së tyre. Kjo vlen njësoj edhe për jomuslimanët, në lidhje me ftesën e tyre në Islam, për ta njohur Islamin dhe mësimet e tij. Po ashtu zbulohet ana e mrekullisë shkencore të Kur'anit fisnik dhe sunnetit të Muhammedit a.s., gjë që ndihmon në afrimin e faqes së kthjellët dhe të pastër islame para tyre, për ta pranuar ose për t'u thelluar në njohuritë islame dhe për ta besuar dhe pranuar Islamin.

4. Kundërshtimi dhe mospranimi i adeteve dhe traditave të këqija të brendshme, të cilat kanë depërtuar dhe depërtojnë në shtetet islame nën adresën e “Vesternizmit”, dhe kjo duhet të bëhet në mënyrë studimore dhe shkencore dhe në prizmin e studimit të përbashkët: fetar e praktik.

ÇKA ËSHTË E RE NË KËTË STUDIM

Paraqitja e fesë si e gjithanshme nëpërmjet sunnetit dhe mësimave mjekësore, të cilat kërkojnë shkurtimin e thonjve, ndalojnë vesin e keq të rritjes së thonjve dhe bëjnë sqarimin e dëmeve të cilat shkaktohen nëpërmjet mos praktikimit të sunnetit. Për këtë arsye, hulumtimi dhe studimi i përbashkët fetar dhe mjekësor i kësaj praktike sunnetike të Pejgamberit në aspekte të ndryshme, konsiderohet program shkencor i ri në përsosmërinë dhe sqarimin praktik.

KAPITULLI I PARË

SHKURTIMI I THONJVE NË DRITËN E SUNNETIT

1. KUPTIMI I SHKURTIMIT TË THONJVE

1. TEKLIMË d.m.th. *prerje, shkurtim*. Çdo herë, kur të hiqet një pjesë prej pjesës tjetër, quhet shkurtim. Për këtë arsye edhe lapsit (kalemit) i thuhet kalem për arsye se shkurtohet vazhdimisht. Thuhet: “*i shkurtova (kalem-tu) thonjtë e mi*”. Duke u nisur nga kjo: Xhevheriu thotë: Më së shumti përdoret fjalia “I shkurtova thonjtë e mi”.

2. SHKURTIMI I THONJVE SIPAS SHERIATIT ISLAM

Heqja e tepërt e pjesës së thoit mbi majën e gishtit është e pëlqyeshme deri në atë masë sa që nuk ka mundësi të mbetet asgjë e dëmshme ndërmjet thoit dhe lëkurës së majës së gishtit.

E PARA: PRERJA E THONJVE ËSHTË PREJ NATYRSHMËRISË

Nga i Dërguari s.a.v.s. janë transmetuar hadithe të vërteta dhe të sakta për natyrshmërinë e njeriut, e njëra prej tyre është shkurtimi i thonjve. Këto hadithe janë të shënuara në koleksionet e vërteta të haditheve: në koleksionet e Buhariut, Muslimit, Malikut, Tirmidhiut, Ebu Davudit dhe Nesaiut r.a., dhe në kapituj të ndryshme si p.sh. në kapitullin “*Cilësitë e të Dërguarit s.a.v.s. në pastërti, në edukatë, në veshmbathje*”.

Tema: cilësitë e natyrshmërisë, tema: shkurtimi i thonjve, tema: shkurtimi i mustaqeve, tema: pastrimi (heqja) prej qimeve nën sqetulla, nga këshillat e Muhammedit a.s. kuptohet se sa me vlerë dhe sa e rëndësishme është prerja e thonjve në edukatën dhe pastërtinë islame.

Nga Ebu Hurejre r.a. transmetohet se i Dërguari s.a.v.s. ka thënë:

“Pesë gjëra janë natyrshmëri e njeriut: sunetia (rrethprerja), pastrimi (të hequrit e qimeve rreth organeve të turpshme), shkurtimi i thonjve, pastrimi (të hequrit) i qimeve nën sqetulla dhe shkurtimi i mustaqeve”.

(MUTEFEKUN ALEJHI)

Transmetohet nga Aishja, nëna e muslimanëve, se i Dërguari s.a.v.s. ka thënë:

“Dhjetë gjëra janë prej natyrshmërisë: shkurtimi i mustaqeve, lëshimi i mjekrës, përdorimi i misvakut, shpëlarja e gojës, prerja e thonjve, pastrimi i organeve të turpshme, rruajtja e nënsqetullës, rruajtja e pjesëve të turpshme dhe pastrimi me ujë i organeve pas kryerjes së nevojës”. Transmetuesi thotë se e ka harruar të dhjetën, por mundet të ketë qenë shpëlarja e hundës.

(MUSLIMI)

3. Nga Ebu Hurejre r.a. transmetohet se e ka dëgjuar të Dërguarin s.a.v.s. duke thënë:

“Pesë gjëra janë të natyrshmërisë së njeriut: sunetia (rrethprerja), pastrimi (të hequrit) i qimeve prej organeve të turpshme, shkurtimi i mustaqeve, prerja e thonjve dhe pastrimi (të hequrit) i qimeve prej nënsqetullave”.

Në një transmetim thuhet:

“Natyrshmëri janë pesë gjëra: sunetia, rruajtja e organeve të turpshme, shkurtimi i mustaqeve, shkurtimi i thonjve dhe rruajtja e nënsqetullave”.

Në një transmetim tjetër si natyrshmëri janë pesë gjëra dhe janë përmend gjërat të cilat u përmendën më sipër.

4. Nga Abdullahu r.a. bin Umeri, transmetohet se i Dërguari s.a.v.s. ka thënë:

“Prej natyrshmërisë janë rruajtja rreth organeve të turpshme, prerja e thonjve dhe shkurtimi i mustaqeve”.

(Transmeton: BUHARIU)

Në transmetimin e Nesaiut thuhet:

“Natyrshmëri është prerja e thonjve, shkurtimi i thonjve dhe rruajtja rreth organeve të turpshme”.

E DYTA: KOHËZGJATJA E MOSPRERJES SË THONJVE

1. Nga Enes bin Maliku r.a. transmetohet se koha e prerjes së thonjve është e kufizuar. Në transmetim thuhet:

“Na ka kufizuar i Dërguari s.a.v.s. në shkurtimin e thonjve dhe shkurtimin e mustaqeve, rruajtjen e nënsqetullave dhe rruajtjen rreth organeve të turpshme në katërdhjetë ditë, pra që të mos zgjatet mos rruajtja apo mos shkurtimi më shumë se katërdhjetë net”.

(Transmeton: EBU DAVUDI, TIRMIDHIU, MUSLIMI DHE NESAIJU)

EBU DAVUDI transmeton: *“Na është kufizuar”.*

NESAIJU e transmeton: *“më së shumti katërdhjetë ditë”*, ndërsa një herë tjetër *“katërdhjetë net”*.

2. Në SAHIHUN E MUSLIMIT transmetohet nga Enesi r.a. se ka thënë: *“Neve, i Dërguari s.a.v.s., na e ka kufizuar shkurtimin e mustaqeve dhe shkurtimin e thonjve në katërdhjetë ditë e katërdhjetë net”.*

3. I Dërguari s.a.v.s ka thënë:

“Kush i shkurton thonjtë në ditën e xhuma e ka mbrojtur veten nga të këqijat.”

(Transmeton: TABERANI nga Aishja r.a.)

Nga gjithë ajo çka u tha, shohim se kufizimi në prerjen e thonjve është si vijon:

1. Maksimumi i kohës, të cilin muslimanit nuk i lejohet ta tejkalojë pa i shkurtuar thonjtë, është katërdhjetë ditë (e katërdhjetë net), sepse përkufizimi ka ardhur në formën e ndalesës me shprehjen *“mos të lejohet”*.

2. Minimumi i kohës është një javë dhe posaçërisht prej ditës së xhumasë deri në ditën tjetër të xhumasë. Shkurtimi i thonjve është prej sunneteve të ditës së xhumasë, sepse është thënë në formën më të butë *“mbrohet nga e keqja”*.

E TRETA: PENGESAT E SHERIATIT NË RITJEN E THONJVE

Mos prerja e thonjve mund të jetë për shkak të përtacisë ose të paditurisë. Kjo është çështje në vete, e cila gjithashtu është e papranuar në shumicën e shoqërive bashkëkohore, për shkak të ndyrësisë së thonjve dhe pamjes së keqe të tyre.

Në anën tjetër, rritja e thonjve mund të konsiderohet si “zbukurim”, ose si “modernizim”, si modë. Kjo cilësi e keqe është përhapur në botë, e pastaj kjo modë ka filluar të përhapet edhe në vendet islame, edhe pse kjo gjë është në kundërshtim me edukatën islame dhe me natyrshmërinë e njeriut, siç na bëhet me dije nga sunnetet e Pejgamberit s.a.v.s.. Posaçërisht, me këtë veti, janë sprovuar gratë e muslimanëve. Sot bota shpenzon shuma të mëdha të mjeteve për mbjelljen e modës së rritjes së thonjve, ndërsa ky është bidat i keq, i cili është në kundërshtim me Islamin. Disa edhe specializohen dhe e quajnë veten maneker për mënyrën e rritjes dhe zbukurimit të thonjve, disa fabrika edhe investojnë për prodhimin e tyre, hapin shitore të posaçme, ku secili dëshiron të mashtrojë dhe të tërheqë sa më shumë blerës, dhe atë nëpërmjet hapave satanike ndërkombëtare për të zbritur njeriun në shkallën më të ulët dhe për të shkatërruar jetën e njeriut në çdo aspekt.

Meqë rritja e thonjve me qëllim, dhe zbukurimi (llakimi) i tyre, është në kundërshtim me Islamin, është detyrë e muslimanëve që të largohen nga ky bidat i keq, sepse përndryshe, ata kryejnë një vepër e cila është në kundërshtim me Islamin. Dhe çdokush, i cili përfiton prej bidatit të keq, ai ka përfituar prej punës të cilën nuk e lejon Islami. Për këtë arsye, ai duhet të largohet nga ai fitim dhe të shikojë rrugë tjetër, e cila nuk është në kundërshtim me Islamin që fitimi i tij të jetë i lejuar (hallall).

PENGESAT E SHERIATIT ISLAM NË LIDHJE ME ZGJATIMIN E THONJVE

1. Bidati (rritja e thonjve) është në kundërshtim me sunnetin e Muhammedit a.s.. Ndërsa muslimanët e kanë për detyrë të pasojnë çdo gjë që vjen prej Muhammedit a.s., dhe të largohen prej çdo ndalese, të cilën e ka ndaluar Muhammedi a.s.

2. Rritja e thonjve mund të jetë shkak për mos depërtimin e ujit në majën e gishtërinjve. Po ashtu, edhe llaku i cili ka yndyrë lëshon një shtresë në thonj dhe në lëkurën e gishtërinjve, kështu që nuk mund të plotësohet abdesi, prandaj është e detyrueshme që të merret abdes përsëri, pasi të largohet llaku apo yndyra.

Ekzistojnë fetva për mospranimin e abdesit në rast se thonjtë kanë yndyrë (manikyr) llaku në thonj dhe patjetër, para abdesit, për t'u pranuar abdesi dhe namazi, duhet të hiqet llaku. Për këtë arsye themi se rritja e thonjve mund të jetë shkak i mospranimit të abdesit.

3. Infektimet të cilat ndodhin për shkak të rritjes së thonjve, të cilat do t'i shpjegojmë më vonë - nëse dëshiron Zoti (in shaAllah) në aspekt mjekësor, për të treguar se ky bidat është në kundërshtim me sheriatin islam, i cili ka ardhur për të mbrojtur njeriun, jetën e tij dhe shëndetin e tij.

“Mos e hidhni veten në shkatërrim me duart tuaja”.

(El-Bekare, 195)

“Mos dëmtoni dhe mos lejoni t'u dëmtojnë”.

4. Rritja e thonjve i përngjet vesit të pabesimtarëve dhe shkatërrimtarëve, dhe është në kundërshtim me edukatën e Muhammedit a.s.. Dhe nuk e teprojmë nëse themi se i përngjan armiqve të Islamit në traditë, veshje, manifestime, veprim i cili është në kundërshtim me ligjet e sheriatit dhe njëkohësisht, nëse rritja e thonjve bëhet për t'u përngjarë pabesimtarëve, është e ndaluar. Kjo nga parimi i ISTIHSANIT, parim i cili parasheh ndalimin e çështjes nëse është në kundërshtim me bazat islame.

5. PERËNDIMIZIMI (VESTERNIZMI) Ky term ka për qëllim - të kulturoarit e muslimanëve me kulturën e perëndimit, duke mos marrë parasysh ndryshimin në fe, gjuhë, adet apo traditë. Kështu që pastaj, me lehtësi, të dominojnë mbi ta dhe t'i largojnë nga feja islame. Në këtë mënyrë, Perëndimi e ka okupuar botën islame, pasi ka planifikuar me strategji planin e perëndimizimit. Kështu që armiq të Islamit, nga jashtë dhe nga brenda, e kanë vënë në veprim këtë projekt, i cili realizohet në shumë forma dhe në shumë mënyra, duke filluar nga “etika” perëndimore, shija, edukata, sjellja dhe përqaftimi i perëndimit. Prej formave të perëndimizimit, e cila është shumë e përhapur, është edhe rritja e thonjve, e cila ka depërtuar te femra muslimane nën mbulojën e “bukurisë femërore” (kozmetikës). Kjo metodë hyn nëpër derën e “bukurisë”, ndërsa ka të bëjë me depërtimin e kulturës perëndimore, e cila është në kundërshtim me parimet islame dhe largim nga All-llahu i Lartmadhëruar dhe nga i dërguari i Tij - Muhammedi a.s.

6. Rritja e thonjve dhe lyerja (llakimi) i tyre, që është shpikje e jomuslimanëve, ka për qëllim, që në emër të “modës”, femra të hyjë në kulturën perëndimore, gjë që asaj i kushton shumë-shumë shtrenjtë, si nga aspekti financiar, ashtu edhe në humbjen e kohës dhe shpenzimin e mundit. Mjafton të themi se lyerja e thonjve kalon nëpër disa faza, të cilat i parashohin të specializuarit (manekerët) e lyerjes së thonjve.

Po ashtu ky lloj “llakimi” nuk përkon me Islamin, sepse femrës i nevojitet që të bëjë vazhdimisht shpenzime pa nevojë, të padobishme, shpenzime të cilat janë në dobi të prodhuesve të tjerë e jo vendorë. Kështu që çdo investim dhe çdo shpenzim që bën femra në lyerjen (llakimin) e thonjve nuk shkon në përputhshmëri me shpenzimet të cilat janë të parapara në shariatin islam, por është teprim në shpenzim, e këtë Islami e ndalon.

7. Lyerja e thonjve, po ashtu, është largim nga natyrshmëria njerëzore, dhe natyra njerëzore (natyrshmëria e njeriut, në të cilin Zoti e ka krijuar njeriun) dhe kalim në atë shtazarak, pra në ngjasimin e kafshëve mishngrënëse me kthetra, dhe në ngjasimin me jomuslimanë dhe darvinistë, apo me fjalë të tjera me evolucionin shtazarak, respektivisht majmunizimin, sepse kafshët me kthetra mishngrënëse dhe njeriu në atë formë nuk kanë kurrfarë dallimi.

Kështu, tentimi për t'u përngjarë kafshëve me rritjen e thonjve është në kundërshtim me ligjet islame dhe degradim i nderimit të njeriut, me të cilën Zoti i Lartmadhëruar e ka ngritur njeriun në formën më të bukur.

Pas kësaj paraqitje të përgjithshme për ndalesën e sheriatit islam për rritjen e thonjve, po e përfundojmë me hadithin e Muhammedit a.s., i cili i ka ndaluar sahabet për rritjen e thonjve.

Bejhekiu, në librin e tij “Shuab” nga Kajs bin Ebi Hazim, transmeton se: Muhamedi a.s. është falur dhe ka dyshuar për diçka. Pastaj është pyetur se për çfarë ka dyshuar dhe ai është përgjigjur: ***“Pse të mos dyshoj, kur ndonjëri prej jush ka fëlliqësirë ndërmjet thoit dhe basamateve (majave të gishtit) të tij”***.

Kuptimi i hadithit ka qenë: *“Ju nuk po i shkurtoni thonjtë tuaj, pastaj në gishtat tuaj po grumbullohen fëlliqësit dhe ndyrësit”*. Ebu Abidi thotë se: *“e ka urreyer tek ata rritjen e thonjve dhe mos shkurtimin e tyre”*.

E KATËRTA: ETIKA E SHKURTIMIT TË THONJVE DHE SI E SHIKON ISLAMI BUKURINË

Islami është fe e përsosur. Veshja, zbukurimi, mbulimi i trupit, pastërtia, ruajtja e shëndetit, mos shpenzimi i tepërt, ruajtja e burrërisë, dhe ruajtja e femërisë për femrat, të gjitha këto i kërkon Islami, dhe të gjitha janë të përfshira në projektin e Islamit, edhe në teori, edhe në praktikë, dhe të gjitha janë të bazuara në librin e All-llahut dhe në sunnetin e të Dërguarit të Tij.

Prerja e thonjve është kërkesë islame. Islami nuk lejon pasimin e epsheve, shfryrjen e dëshirave dhe realizimin e planeve të shejtanit. Pasi Islami është gjithëpërfshirës dhe i përsosur për nevojat e njeriut në këtë botë dhe në botën tjetër, dhe pasi etika, estetika dhe morali janë nevoja të njeriut, dhe meqë është kërkesë e Islamit që muslimani të ketë etikë dhe estetikë, atëherë patjetër muslimanët këtë çështje duhet ta shohin në prizmin e sheriatit islam.

Prerja e thonjve në sheriatin islam duhet të jetë plotësim i këtij parimi. Për këtë arsye, prerjen e thonjve si sunnet e takojmë në shumë kapituj të haditheve, si në kapitullin e etikës, pastërtisë, veshjes, edukatës, ashtu edhe në atë të natyrshmërisë së njeriut.

Etikën dhe estetikën e prerjes së thonjve, si kërkesë të sheriatit islam, mund ta shpjegojmë si vijon:

1. All-llahu e ka krijuar njeriun në formën më të bukur. Prej formës më të bukur janë edhe bukuria e thonjve, e cila ndihmon në kryerjen e punëve të shumta dhe i ruan majat e gishtërinjve, dhe qëllimi kryesor i thonjve është mbrojtja e majave të gishtërinjve, dhe kjo bëhet me mos tejkalimin e tyre mbi gisht, se vetëm kështu ato e luajnë rolin e tyre.

2. Prerja e thonjve është prej natyrshmërisë së njeriut dhe vetëm kështu ruhet bukuria e tyre. Për këtë arsye quhet prerje e thonjve, dhe jo heqja e tyre, me qëllim që vetëm pas prerjes ato e kryejnë rolin e tyre.

3. Për t'i larguar ndyrësitat dhe për t'i mos i lejuar mikrobet që të grumbullohen. Sikurse rruajtja e nënsqetullave, ashtu edhe prerja e thonjve është stoli dhe bukuri, për këtë arsye çdo gjë që është në kundërshtim me të bukurën është e papranuar. Islami e kërkon bukurinë dhe, në të njëjtën kohë, kërkon largimin e ndyrësirave dhe mikrobeve. Pra, prerja e thonjve, nuk u lë vend mikrobeve dhe ndyrësirave.

Me prerjen e thonjve arrihen tri qëllime kryesore: heqja e pjesës së thoit shtesë, moslejimi i grumbullimit të mikrobeve dhe ndyrësirave, dhe pastrimi i lehtë, i shpejtë dhe i plotë i majave të gishtërinjve. Pasi pastërtia është pjesë e imanit, me prerjen e thonjve arrihet pastërtia e duarve, dhe njëkohësisht edhe e trupit.

4. Prej kushteve të etikës dhe estetikës në sheriatin islam është mbulimi i pjesëve të turpshme, edhe te meshkujt, edhe te femrat. Femra nuk stoliset me rroba të cilat i zbulojnë organet e turpshme të tyre, ose që janë të tejdukshme dhe u shihet trupi. Po ashtu edhe mashkulli nuk lejohet të vishet me rroba të tejdukshme, me të cilat shihen organet e turpshme të tyre. Femra nuk lejohet që të mbajë byzylyk që ndeshen mes vete dhe që i dëgjojnë të tjerët, përpos familjarëve të ngushtë. Po ashtu nuk lejohet që të parfumohet për të tjerët, në vend se të parfumohet për burrin e saj. Shkurtimi i thonjve është sunnet për muslimanet, ndërsa rritja e tyre është përngjasim me pabesimtaret, sikurse përngjasim me pabesimtaret është edhe ngjyrosja, llakimi sepse kjo bën që të shihen prej jofamiljarëve, sepse, në përgjithësi, gishtat janë pjesa që është vazhdimisht jo e mbuluar.

5. Maturia dhe mos shpenzimi i tepërt në stolisje është çështje e domosdoshme në sheriati islam. Me shkurtimin e thonjve shpenzimet janë të vogla, modeste dhe janë lehtësuese, ndërsa e kundërta, zgjatja e tyre, kërkon shpenzime të shumta në llakim, ngjyrosje dhe përkujdesje të madhe në ruajtjen e tyre për mos lakuarjen dhe mos thyerjen e tyre.

6. Zoti i Lartmadhëruar e ka fisnikëruar dhe e ka dalluar njeriun prej kafshëve, dhe çdo ngjasim i kafshës është i papranuar në sheriati islam. Bukuria në islam duhet të jetë në përputhshmëri me natyrën e njeriut, ndërsa rritja e thonjve është ngjasim me kafshët dhe është në kundërshtim me normat e bukurisë, etikës dhe estetikës islame.

KAPITULLI I DYTË

SHKURTIMI I THONJVE NË DRITËN E MJEKËSISË

Në këtë kapitull, do të orientohe mi posaçërisht në dëmet, apo pasojat e mos shkurtimit të thonjve, të cilat i kemi përmendur në kapitullin e parë. Ne, nëse dëshiron Zoti (INSHAALLAH), do të përqendrohemi në këto tema:

1. Studim i përgjithshëm
2. Pasojat e gishtërinjve prej rritjes së thonjve
3. Pasojat e thonjve për shkak të rritjes së tyre
4. Pasojat për shkak të ngjyrosjes dhe llakimit të tyre

E PARA:

1. PËRKUFIZIMI

Thoi është pjesa shtesë, e cila mbulon majën e gishtit të këmbës, ose të dorës, së njeriut.

2. PAMJA E JASHTME

Thoi përbëhet prej rrënjës (NAIL MATRIX) dhe prej pjesës e cila e mbulon majën e gishtit (NAIL PAD), e cila quhet shtrati i thoit. Ky është funksioni normal i thoit. Çdo shtresë, apo pjesë, e cila zgjatet apo rritet mbi funksionin normal të thoit, quhet *tepricë*.



SKEMA 1.

3. FUNKSIONIMI NORMAL I THOIT

Majat e gishtërinjve duhet të mbrohen që të jenë të fortë për funksionim normal të tyre gjatë prekjes së sendeve të ndryshme. Për këtë arsye, rritja e thonjve, pra pjesa shtesë e thoit mbi majat e gishtërinjve e humb fuqinë, nuk ka vlerë, dhe dëmton majën e gishtërinjve.

4. RRRITJA E TEPËRT E THONJVE

Pjesa e tepërt e thoit është shtesa mbi majën e gishtit, që e dobëson funksionimin normal të tij dhe rritja mbi majën e gishtit është në kundërshtim me shkurtimin e thonjve për të cilën kemi folur në kapitullin e parë. Ajo që na intereson tani është rritja e thonjve me qëllim, gjë që është një bidat i shëmtuar i ardhur prej vendeve jo islame nën adresën *“Moda e zgjatjes së thonjve”*.

Ky është zbukurim artificial, prandaj edhe është bidat i shëmtuar. Zgjatimi minimal është 1 cm, por mund të rritet edhe më shumë, sikurse e parashohin “ekspertët” (manekerët) e këtij bidati të shëmtuar, me forma të llojllojshme, që bazohet në parallogaritë e tyre, duke e zvogëluar gjerësinë e tyre deri në përfundimin e thoit. Thoi mund të rritet aq shumë nga normalja sa që i ngjason kafshëve me kthetra si formë zbukurimi të cilin e parashohin ekspertët e modës (manekerët) së zgjatimit të thonjve.

Pas rritjes së thonjve (të cilat lakohen dhe formohet shpina) formohet një zbrazëtirë e thonjve, që ndryshe është lugu i thoit, i cili fillon prej majës së gishtit e deri te maja e thoit. Në këtë lug tubohen ndyrësitat e të gjitha llojeve. Për t’i larguar ato nevojitet pastrimi i lugut të atij thoi me mund dhe angazhim të madh, gjë të cilën duhet ta bëjë vetëm eksperti apo profesionisti i zbukurimit të thonjve.

Pra, edhe pse pastrimi bëhet kohë pas kohe, vazhdimisht, në lug, në pjesën më të madhe të kohës, ndodhen papastërti, ndyrësi dhe mikrobe.



SKEMA 2. TREGON RRITJEN E THONJVE

PASOJAT TË CILAT SHKAKTOHEN PREJ RRITJES SË THONJVE

Me këtë kemi për qëllim dëmet që i shkakton pjesa shtesë (rritja) e thoit. Këto dëme duhen shikuar nga dy aspekte themelore:

1. Lugu i thoit, i cili formohet pas rritjes së thoit, prej majës së gishtit, deri te maja e thoit, në të cilën grumbullohen ndyrësit, mikrobet dhe elementet e tjera të dëmshme.

2. Rritja e thonjve e cila zgjatet më shumë se maja e gishtit, që e dëmton vet personin, ose të tjerët, ashtu siç mundet të bëhet shkak i mos lëvizjes normale të gishtërinjve.

A) Dëmet të cilat shkaktohen për shkak të lugjeve të thonjve

1. Në lugjet e zgjatimit të thonjve grumbullohen ndyrësira dhe elemente të tjera të dëmshme, të cilat konsiderohen burim i sëmundjeve dhe të cilat kursesi nuk mund të eliminohen, pavarësisht se pastrohen (SKEMA NR. 2). Po ashtu është vështirë për t'i pastruar duart, gjë që ndikon në përhapjen shumë të shpejtë të sëmundjeve, të cilat përhapen nëpërmjet gojës. Nga ana tjetër, thonjtë të cilët shkurtohen vazhdimisht, nuk i kanë këto lugje dhe nuk bëhen strofull i mikrobeve. Po ashtu, larja dhe pastrimi i tyre bëhet lehtë, posaçërisht me ujë, kur të merret abdesi për namaz. Për këtë arsye, në gishta nuk grumbullohen ndyrësit, ose bartësit e sëmundjeve - mikrobet.

Ne vërejmë se librat mjekësore dhe librat për shërimin e sëmundjeve, kur flasin për disa sëmundje të cilat përhapen nëpërmjet gojës, në shumicën e rasteve përkujtojnë preventivën apo shërimin nëpërmjet shkurtimit apo pastrimit vazhdimisht të thonjve. Prej sëmundjeve, që mjekësia ka vërtetuar se ka preventivë shkurtimin dhe pastrimin e thonjve, është sëmundja "Entrobiasis", e cila, tek njeriu, shkakton po ashtu sëmundjen tjetër Oxyuris (shiko skemën nr. 3).

Për këtë arsye, njeriu duhet të ketë parasysh që t'i shkurtojë thonjtë vazhdimisht si preventivë prej sëmundjeve dhe si natyrshmëri e njeriut. Ky është edhe parimi i mjekësisë preventive, e cila e tregon rëndësinë dhe rregullat e shërimit të sëmundjeve dhe ruajtjen e shëndetit të njeriut. Për këtë arsye, edhe muslimani, edhe jo muslimani, duhet t'i përmbahet rregullit të shkurtimit të thonjve.

2. Në lugjet e zgjatimit të thonjve, gjithashtu tubohen lëndët e ushqimit si yndyrat, ose elementet e trupit të cilat mbesin dhe preken me thonj. Pastaj, këto elemente është mjaft vështirë për t'i hequr me pastrim të rëndomtë, dhe ato yndyra dhe elemente bëhen burim i erërave të urrejtura.

Prej veprimeve që kërkohen për të mos lejuar preken e lëndëve helmuese, është moslejimi i zgjatjes së thonjve, sepse nëse lëndët helmuese depërtojnë në lugjet e zgjatimit të thonjve, vështirë se ato të mund të largohen me pastrim të rëndomtë të duarve, dhe nëpërmjet thonjve dhe gojës ato pastaj shumë lehtë mund të depërtojnë në trupin e njeriut, gjë që shkakton plogështinë dhe dobësimin e shëndetit.

PENETROJNË DHE
ZHVILLOHEN NË MUKOZË.
KRIMBAT E RINJ RRITE NË
ZORRËN E HOLLË TË POSHTME
DHE ZORRËN E TRASHË TË
EPËRME.

LARVAT
DALIN NGA
VEZA NË ZORRË

KRIMBAT GRAVIT
MIGROJNË NË REKTUM

MADHËSIA
AKTUALE

VEZËT
(E KRIMBAVE)
JANË TË
LËSHUARA
NË REGJONIN
ANAL
PERIFERIK.

GËLLTITJA E VEZËVE TË
EMBRIONIZUAR PËRMES
THONJVE.

CIKLI JETËSOR TË ENTEROBIUS VERMICULARIS
(KRIMBI I ZORRËVE)

SKEMA NR. 3.

DËMET DHE PASOJAT NGA THONJTË E GJATË


1. Njeriu mund ta dëmtojë veten nga thonjtë e rritur, por në të njëjtën kohë edhe të tjerët. Prej dëmeve të përhapura është infektimi i syrit kur thoi i rritur bie ndesh me të. Po ashtu, infektimi i dregëzës nëse personi ka qenë më herët i lënduar, posaçërisht kur thonjtë janë shumë të rritur.

2. Të rriturit e thonjve mund të jetë shkak i pengimit të lëvizjes së lirë të gishtave (shiko skemën 4), kur tentohet që me majë të gishtërinjve të kapet diçka, ose të mbahet diçka, ose të preket diçka. Është e qartë dhe e sigurtë se thonjtë e rritur i pengojnë këto veprime. Sa më të gjatë të jenë thonjtë aq më të vështirë dhe aq më dëmtues janë.

Nga ajo që thamë, vërejmë:

- Vështirësia e të prekurit të sendeve;
- Vështirësia e kapjes së sendeve normalisht, për shkak të thonjve të gjatë, të cilat e prekin shputën e dorës para se të kapet sendi me gishta.

3. Mos lëvizja normale e gishtave në lirimin dhe shtrëngimin e duarve për shkak të thonjve të gjatë nuk ka dyshim se pengon veprimtarinë e gishtave, gjë që shkakton jo vetëm dëmtimin, por edhe paralizimin e tyre.



Skema nr. 4.


E TRETA: PASOJAT TEK VETË THONJTË PËR SHKAK TË ZGJATIMIT TË TYRE

Prej dëmeve që shkaktohen prej rritjes së thonjve janë edhe dëmet në vetë thonjtë dhe dëmi në lëkurën dhe mishin, i cili është rreth e përqark gishtit dhe thoit. Për këtë arsye, dëmet janë dy lloje:

a) Dëmet të cilat shkaktohen drejtpërsëdrejti në vetë rritjen e thoit.

- Plasaritja dhe thyerja e thoit të rritur, e cila është e vazhdueshme, dhe kjo zakonisht ndodh me ndeshjen e sendeve të forta.

- Ndezja e rrënjës së thoit, dhe kjo pikërisht për shkak të rritjes tepër të madhe, kështu që rrënja e thoit për shkak të largësisë së madhe nuk mund ta dirigjojë dhe kontrollojë. Shkak i ndezjes është lëvizja e dorës dhe e gishtërinjve, e cila reflektohet drejtpërsëdrejti në vetë thoin.



SKEMA NR. 5.

b) Hipertorfia mund t'i bëjë thonjtë t'u ngjasojnë kthetrave. Ky tip mund të shkaktohet nga trauma apo çrregullimet vaskulare periferike (anësore). Shkaktari më i shpeshtë është pakujdesia (mosprerja e thonjve në periudha shumë të gjata kohore).

1-3. Onychauxis:

Thonjtë janë shumë të holluar, por pa deformitet (hipertrofia e thjeshtë). Hollësimi i thjeshtë i thonjve mund të jetë për shkak të traumës.

1-4. Linjat (vijat) e Beaus-it.

Këto janë rrudha (brazda) tërthore që fillojnë me matriks (matrice) dhe zhvillohen më tutje gjatë rritjes së thonjve. Faktorët e ndryshëm sistematikë dhe lokalë traumatikë mund të shkaktojnë këtë gjë... Trauma mund t'i shkaktojë ato.

1-5. Leuchonychia e Wit Analis (grima analise)

Dyshimi, shpesh i theksuar, që mund të shkaktohet nga trauma, infektimet e gishtërinjve...

E KATËRTA:

DËMET TË CILAT SHKAKTOHEN PËR SHKAK TË NGJYROSJES DHE LLAKIMIT TË THOIT

Edhe për shkak të ngjyrosjes dhe llakimit të thonjve rezultojnë dëme të konsiderueshme. Llakimi bëhet në forma dhe mënyra të ndryshme.

a) MANIKYR - Ky lloj i llakimit përfshin disa procedura.

1. Formimi i thonjve si kthetra, pra të formuarit e thonjve për t'iu përngjarë kafshëve shqyese me kthetra (shiko skemën nr.6).

2. PINGJING - shtypja e thonjve të mëdhenj dhe formësimi ashtu siç e kërkon klienti.

3. Ndryshimi i formës së thoit me gërshtë (stabing)

4. Forcimi i thonjve (HARDENING). Kjo bëhet nëpërmjet mjeteve të posaçme për forcimin e thonjve (Nail Hardners).

5. Llakimi apo ngjyrosja e thonjve për qëllim të zbukurimit të tyre me llak apo ngjyrë të posaçme (shiko skemën nr.7).

6. Heqja e llakut apo ngjyrës. Kjo për shkak të llakimit apo ngjyrosjes edhe një herë më mirë, me ngjyrë apo llak tjetër.

b) Mbjellja e thonjve (Body implantation). Kjo për zbukurim, por edhe si formë e thonjve të mëdhenj.

c) Vendosja e thonjve artificialë: janë thonj artificialë prej lëndëve bitrokimike (ikrilik), të cilat kanë forma të ndryshme, gjatësi të ndryshme dhe ngjyra të ndryshme. Vendosen mbi thoin natyral për t'iu dhënë thonjve formën e kërkuar dhe të pëlqyer (shiko skemën nr. 8).



SKEMA NR. 6.



SKEMA NR. 7.



SKEMA NR. 8

Dëmet dhe infektimet të cilat shkaktohen prej thonjve janë të shumta, por në përgjithësi ndahen në dy grupe:

E para: Sëmundjet e vetë thonjve.

E dyta: Ndezja e lëkurës përreth tyre, për shkak të kozmetikës së tyre.

E PARA: SËMUNDJET E THONJVE

1.Onychorrheksisi (thonjtë e brishtë).


Brishtësia në thyerjen e thonjve mund të rezultojë nga sapuni tepër i fortë dhe ekspozimi ndaj ujit, nga larguesi i llakut të thonjve (acetoni) etj. ...

2.Onychoschizia:

Ndarja e thonjve skajorë në shtresa, tek skaji i lirë, është një problem shumë i shpeshtë në mesin e grave, dhe paraqet një ngjitje të mbështjellësve të keratinës, me siguri për shkak të dehidrimit. Po ashtu, mund të ndodhin edhe ndarjet gjatësore. Llakimi i thonjve duhet të ndalet...

3.Onycholysis:

Onycholysis është një ndarje spontane e pllakës së thoit. Zakonisht fillon në një anë të lirë dhe vazhdon më pas duke u zhvilluar... Shkaktarët sistematikë kanë qenë të numëruar p.sh. hiper dhe hipotrodizmi, shtatzëni dhe sifilizi...in situ (në vend). Shkaktarët mund të jenë trauma e nxitur nga gërvishtja, pickimi, shtrëngimi, therja (gjatë manikyrimit) dhe implantimi i trupave të huaj ... Shkaktarët kimikë mund të jenë përdorimi i tretësve, mbështjellësi bazik i thonjve, forcuesit e thonjve që përmbajnë derivate të formalinës, thonjtë artificiale, apo zhytja në ujë të nxehtë alkaline ... Mjekimi konsiston në aplikimin ditor të ilaçeve të ndryshme ... Trauma duhet të mënjanohet tërësisht.



SKEMA NR. 9.

E DYTA: NDEZJA E LËKURËS PËR SHKAK TË ZBUKURIMIT TË THONJVE

Prej këtyre veprimtarive dhe formave të tjera të zbukurimit të thonjve, shkaktohet ndezja e lëkurës. Po përmendim disa indikacione dhe infektme:

1. Llakimi i thonjve

Përbëhet prej lëndëve sulfonamides dhe formaidehyde, lëndë të cilat janë shkaktaret kryesore të ndezjes së lëkurës rreth syve dhe rreth qafës.

2. Të kremuarit e fortë të thonjve

Thonjtë të cilët kremohen me krem të fortë dhe të thartë siç është p.sh. astoni, shkaktojnë krisjen dhe plasaritjen e thonjve.

3. Thonjtë artificiale. Lënda e acrylikut mund të shkaktojë alergji sensitive. Po ashtu, në këtë infektim ndikon edhe lënda glue, të cilën e posedojnë thonjtë artificiale.

4. Përbërja e fortë e thonjve artificiale në përgjithësi përbëhet prej formaldehydeve, të cilat shkaktojnë alergjinë sensitive, paronychinë onychomadesisin dhe humbjen e rrënjëve të thonjve, dhe thonjtë në përgjithësi. Shiko skemën nr. 10.



SKEMA NR. 10.

REZULTAT I KËTIJ ANGAZHIMI

Shkurtimi i thonjve është sunnet i peygamberit, është një çështje që çdo musliman duhet ta praktikojë patjetër për të qenë në dëgjueshmëri ndaj Allahut të Lartmadhëruar dhe të dërguarit të tij, për ta ruajtur shëndetin si preventivë mjekësore, gjë që është vërtetuar në bazë të studimeve të sëmundjeve të lëkurës.

PËRFUNDIM

Ky hulumtim (shkurtimi i thonjve) është një vepër me të cilën duhet t'u kundërvihemi adeteve dhe veprimeve të këqija, të cilat janë në kundërshtim me mësimet islame dhe (kjo vepër) është bërë me logjikë shkencore dhe në bazë të studimeve të specializuara.

Me këtë rast po përkujtojmë apelin që ka qenë në të kaluarën, se shkurtimi i thonjve është sunnet. Dërrasat e zeza të shkollave kanë qenë të mbushura vazhdimisht me këshilla dhe udhëzime, dhe një prej atyre këshillave ka qenë: “Shkurtoni thonjtë”. Po ashtu, nxënësit e shkollës në rresht, kontrolloheshin në mënyrë precize dhe të vazhdueshme se a i kanë shkurtuar thonjtë, apo jo. Kështu duhet të veprohet vazhdimisht për këtë çështje, por edhe për çështje të tjera.

POROSI

Luftimi i dukurisë negative “të rritjes së thonjve dhe formave të tjera të kozmetikës së thonjve dhe dukurive të tjera negative” nëpërmjet edukimit islam, dhe duke paraqitur për këtë qëllim elaborime të sqaruara dhe të specializuara për edukimin e shoqërisë.

Literatura e konsultuar

1. Kur'ani fisnik.
2. Ibn Ethiri el Mubarek bin Muhamed “Xhamiul Usul fi ehadithi err rresul”. Botues Mektebetu Durul Bejan. Botuar në vitin 1930 h.
3. Ibn Kajim el Xhevziju, Muhamed bin Ebi Bekire “Zadul Mead fi hedji hajril Ibad Muessetu erisaletu”, Bejrut botimi i dytë, viti 145h.
4. Shijbetul Hamd, Abdul Kadir: Fikhul islam, Sherh Bulugil Meram, Metabiurr rreshid bil Medinetil Munevere. Botimi i parë.
5. Abdul Xhevad, Ahmed: Ed duaual Mustexhab minel hadithi vel kitab. Sheriketul Mekete hitabaati ven neshri.
6. Umeri Muhamed Abdul Aziz “El libas ve zinetu fi esh sheriatil Islamijeti. Musseseti risaleti Bejrut. Botimi i tretë, viti 1406 h.
7. Uvejdatu Ali Muhamed “El Muaxhem Tibiju es Sejdaliju El hadith. Durul fikri el Arabij, Kajro. Botimi viti 1970 e.s.
8. Ibn Mendhur Xhemaludin Muhamed bin Mekrem Lisanul Arab Daru sadin Bejrut.
9. Neveviju Jahja bin Sheref “Rijadu es Salihin” Darul Mëmun li turath, Damask, Botimi i dytë.
10. Milton J. Chatton: Medical Treatment, XIV Ed. 1980. Jones Medical Publication, California, U.S.A., Libr. Rie de Liban, Beirut.
11. Andrews', Diseases of the Skin, Clinical dermatology, 7th Ed.

Fusnotat

1. Ka për qëllim shkurtimin dhe prerjen e thoit që është më e tepërt se maja e gishtit.
2. Thonjtë e duarve dhe të këmbëve të njeriut (sh. Edhfar, edhafijr, edhafir, dhufur).
3. Me këtë kemi për qëllim pjesën e shkencave praktike, të cilat quhen (shkenca natyrore) dhe që është e përafërt me terminologjinë evropiane (Science).
4. Sureturr- Rrum, 30.
5. “Juve ju kam lënë dy gjëra që nëse u përmbaheni nuk do të humbni kurrë: Librin e All-llahut dhe sunnetin tim”.
6. “Çka ju jep (këshillon e urdhëron) i Dërguari pranojeni e çka ju ndalon, largohuni”. (Suretul Hashr, 7)
7. “Lisanul arab” vol. 12 fq. 490-491.
8. “Veshja dhe zbukurimi në sheriatin islam” fq. 406-407.
9. Rijad es salihin fq.471 nr. i hadithi 1201. Kapitulli-Vlera e pastrimit të dhëmbëve (sivak) dhe virtytet e natyrshmërisë.
10. “Rijad es salihin fq. 472, nr. 1202, kapitulli – Vlera e pastrimit të dhëmbëve dhe e natyrshmërisë.
11. “Xhamiul usul fi ehadith err rresul” fq. 774, vol. 4, nr. i Hadithit 2930. Transmeton Muslimi, Tirmidhiu, Ebu Davudi, Nesaiu (Eka transmetu Muslimi, nr. i hadithit 260, në librin, “Pastërtia”, Kapitulli “Virtytet e natyrshmërisë”. Ebu Davudi, hadithi nr. 53, në librin “Pastërtia”, kapitulli “Pastrimi i dhëmbëve (sivaku) prej virtyteve të natyrshmërisë”.

Tirmidhiu nr. i hadithit 2758, në librin “Edukata”, Kapitulli “Mbi shkurtimin e thonjve”. Nesaiu 8-126 dhe 127. Mbi zbukurimin, Kapitulli: “Sunnetet e natyrshmërisë”.

12. “Xhamiul Usule”, fq. 773. Volumi i katërt nr. i hadithit 2928, (Transmeton Buhariu 10-282-293) mbi veshjen. Kapitulli “Shkurtimi i mustaqeve” dhe kapitulli “Shkurtimi i thonjve” dhe kapitulli “Kërkimi i lejes”. Kapitulli “Sunetia pas moshës madhore” dhe të rruarit e nënsqetullave. Po ashtu, transmeton Muslimi nr. i hadithit 257, në kapitullin “Mbi pastërtinë” dhe kapitulli “Virtytet e natyrshmërisë”, “Muvetau” 2-921. Mbi cilësinë e Muhammedit s.a.v.s. Kapitulli “Mbi sunnetet e natyrshmërisë”. Tirmidhiu nr. 2757 “Edukata” Kapitulli “Shkurtimi i thonjve”, Ebu Davudi nr. i Hadithit 4198. „Terexhul”, Kapitulli „Mustaqet”, Nesai 1-14,15 Pastërtia Kapitulli „Shkurtimi i thonjve” dhe Kapitulli „Rruarja e nënsqetullave”.

13. “Xhamiul Usul”, fq. 774, volumi 4, nr. i hadithit 2929 (transmeton Buhariu 10-295) Libër. Veshja, Kapitulli “Shkurtimi i thonjve” dhe Kapitulli “Shkurtimi i mustaqeve” Nesaiu 8-15, mbi zbukurimin, Kapitulli “Rruarja e organeve të turpshme”.

14. “Xhamiul Usul”, fq.775, volumi 4, nr. i hadithit 2932, (Transmeton Muslimi, nr. Hadithit 258). “Mbi pastërtinë”. Kapitulli “Virtytet e natyrshmërisë”, Ebu Davudi (4200), “Terexhul Kapitulli „Mustaqet” Tirmidhiu nr. i hadithit 2759 “Edukata”, Kapitulli 16, Libri “Pastërtia”, Kapitulli “Koha e shkurtimit të mustaqeve”.

15. Zadul Mead, fq. 178, vol. 1 (Transmeton Muslimi 258, “Mbi pastërtinë”, Kapitulli “Koha e shkurtimit të thonjve dhe mustaqeve” Nesaiu 1-15,16, “Mbi pastërtinë” Kapitulli “Koha e shkurtimit të mustaqeve”, Ebu Davudi (4200), Terexhul, Kapitulli “Mustaqet”.

16. “Duaul Mustexhab minel hadithi vel kitab”, fq. 71

17. Shkurtimi i thonjve është sunnet - për këtë të gjithë pajtohen unanimisht. Kur të rriten, nuk duhet të vonohet koha për t'i shkurtuar, por më i vlefshëm është shkurtimi i thonjve para namazit të xhumasë. Argumentim për këtë është hadithi i transmetuar nga Ebu Hurejre r.a. se Pejgamberi s.a.v.s. i shkurtonte thonjtë dhe mustaqet ditën e xhumasë, para se të shkonte në xhami. Kur është pyetur Imam Ahmedi, për këtë ka thënë: Sunnet është ditën e xhumasë para zevalit, ai ka dhënë mendim ditën e enjte, por mundet edhe të zgjedhë. Mustehab është sipas nevojës. Imam Neveviu thotë: - Kjo varet prej kohërave dhe gjendjes së personit. Pra siç e kërkon për të gjitha sunnetet e natyrshmërisë. Mirëpo kjo nuk mundet të jetë pengesë për të mos i shkurtuar thonjtë ditën e xhumasë. Përkujdesja sa më e madhe dhe e vazhdueshme në pastërti është e pëlqyeshme në sheriatin islam. Zbukurimi në sheriatin islam fq. 407. Shiko “Fet-hul Kebir fi dami Ez-zijadetu ila Xhamii, Sagir. Sujutiju-Halebij vol. 2-385. Fethul Bari, vol. 10, fq. 346.

18. Në hadithin ‘plotësimi i abdestit’ Muhammedi a.s. ka thënë: “(*plotësim*) *përfshirja e plotë e të gjitha pjesëve*”. (“Fikhul islam” fq. 44 vol. 1)

19. Muhammedi a.s. e ka parë një njeri i cili kishte marrë abdes dhe nuk e kishte përfshirë me ujë një pjesë të thembrës, dhe i ka thënë: “*Plotësoje abdesin*”. Transmeton Ebu Davudi dhe Nesaiju. Hadithi tregon se duhet të përfshihet e tërë pjesa e trupit me ujë (“Fikhul islam”, fq. 55, vol. 1).

20. Ajo çka vendoset mbi thonj prej yndyrave, ngjyrave, llakut (i cili quhet manikyr) e pengon depërtimin e ujit në atë hapësirë kështu që e bën abdesin të pavlefshëm. (EL-LIBAS VE ZENETU FI SHERIATU ISLAMJETI fq. 406)

21. Me shkurtimin e thonjve ka për qëllim heqjen e pjesës së thoit i cili rritet më shumë se maja e gishtit, sepse ndyrësiat dhe mikrobet që gjejnë vend aty, mund të arrijnë deri në atë masë, sa që të pengojnë depërtimin e ujit, aty ku është e paraparë për t'u pastruar gjatë gusulit dhe pastrimit. Disa dijetarë prej Medhhebit Shafij, mendojnë se abdesi në atë mënyrë është i pavlefshëm. Po aty, fq. 406.

22. Në temën (ET-TEGRIB BIT-TERGIB BI KIJEMIL GARB VE AHLAKIHI VELINTISARI LI SHAHSIJETIHI) vjen me titullin (MEKAJIS XHEMALIL MERETI). Përkufizimi i zbukurimit të femrës në kufijtë të cilat kanë ardhur prej perëndimit është zhveshja nga Islami dhe rregullat edukative të tij dhe orientim drejt vesternizimit.

ENEMS VE TENEMUS quhet tatuisti i cili bën tatuazhe të cilat janë të ndaluara sipas hadithit sherif (All-llahu i ka mallkuar ata, të cilët i heqin vetullat dhe u heqin vetullat (të tjerëve) dhe ata që shkruhen dhe shkruajnë (tatuazhe).

Heqja e vetullave.

Nëse vëren se flokët e tua (rrënja e tyre) fillojnë të thahen, atëherë përdoret shampon në të cilën ka yndyrë ose e kuqja e vezës. Në të kuqtë e vezës mund të shtohet një lugë "Rum". Ky lloj shamponi i forcon flokët. Edhe pse kemi mendim të mirë për autoren ne mendojmë se ajo nuk e di se (pija e alkoolit rum) është njëra prej pijeve më të forta alkoolike të ndaluara. "Rumi" është pije alkoolike e cila prodhohet me shtrydhje dhe është dehëse.

23. Sureturr- Rrum, 30

24. Ajo çka veprojnë sot femrat e pandershme, të cilat dëshirojnë t'i mashtrojnë meshkujt me zgjatimin e thonjve, të cilat iu përngjajnë thonjve të qenve dhe të kafshëve është veprim i nënçmuar, pasi është në kundërshtim me natyrshmërinë, të cilën e ka krijuar Zoti, dhe nuk përkon me shëndetin. "Kitabu libas vez-zijneti fi sheriatu islamijeti", fq. 407".

25. “El-libas vez-zijnetu fi sheriati islamijeti”, fq. 406.

26. Transmetues të besueshëm, edhe pse është i këputur Taberania e ka ngjitur në një rrugë tjetër. ER-REFG është pluhuri në trup, si nënsqetulla, në mes të veshëve, në mes të kukeve dhe në çdo vend ku tubohen ndyrësit.

27. Shiko “Fethul Bari”, vol. 20, fq. 345.

28. “O bijtë e Ademit, vishuni mirë dhe zbukurohuni çdo herë para se të shkoni në xhami”. (EL EARAFË, 31). Në këtë ajet fjala “Zinetu” ka për qëllim mbulimin e organeve të turpshme.

29. “Le të mos kërcasin me këmbët e tyre për të zbuluar fshehtësinë nga stolitë e tyre. Pendohuni të gjithë te Allahu, o besimtarë, në mënyrë që të gjeni shpëtim”. (En-Nurë, 31)

30. Thonjtë e kafshëve ndryshojnë (claws) nga thoi i njeriut. Thonjtë e kafshëve janë të gjata dhe të mprehta dhe u shërbejnë kafshëve për ta shqyer gjahun.

31. Quhen (lugjet e thoit) ose (shpellat e thoit).

32. Shiko hadithet e Pejgamberit, të cilat i kemi përmendur në Kapitullin e Parë, dhe sqarimin e mrekullueshëm të cilat tregojnë se çfarë bartin thonjtë prej ndyrësirave (ndyrësit dhe mikrobet në mes të thoit dhe gishtit ... Hadithi) dhe të cilat tregojnë anën preventive prej shkurtimeve të thonjve (“*Kush i shkurton thonjtë ditën e xhumasë e siguron veten prej të këqijave*” e të ngjashme ... Hadithi). Vështrimi në mrekullinë shkencore të këtyre dhe haditheve të tjera vërteton sineritetin e thirrjes dhe sineritetin e thirrësit me të mirë, pra, të pejgamberit Muhammed s.a.v.s. Shiko madhësitë e Islamit në mesin edukativo-arsimor prej këshillave të Dërguarit të All-llahut s.a.v.s.

33. Në disa libra mjekësorë përmendet shërimi i ilaçit me ilaç. Kjo lloj sëmundje paraqitet për shkak të kalimit të vezëve prej thonjve në gojë dhe është sëmundje ngjitëse.

Shërimi

I. Procedura e përgjithshme: u jepet bari të sëmurëve prej familjes, ose të tjerëve të cilët kanë qenë të përzier dhe këshillohet që t'i pastrojë duart me ujë dhe sapun, pas dhe para ushqimit.

Duhet që thonjtë e duarve të jenë të shkurtra dhe të pastra. Të infektuarit këshillohen që të mos e prekin me thonj gojën.

II. Dermatitis (pezmatimi i lëkurës) kozmetik:

1. Llakërat e thonjve: këto përmbajnë rrëshira sulfonamidike dhe formaldehike dhe janë shkaktarët më të shpeshtë të dermatitizit të kapakëve të syrit dhe atij të qafës.

2. Larguesi i llakut të thonjve.

Këto janë tretës siç është acetoni, që mund të shkaktojnë brishtësi të thonjve.

3. Thonjtë artificialë: monomeret akrilikë mund të prodhojnë ndjeshmëri alergjike, po ashtu edhe ngjitësi i cili duhet për të ngjitur thonjtë artificialë prostetikë.

4. Forcuesit e thonjve: Formaldehidi është forcuesi i thonjve më i shpeshtë dhe prodhon ndjeshmëri alergjike. Paronychia, onychomadesis dhe hemorragjia sabranguale mund të jenë rezultat i përdorimit të këtyre forcuesve.

LIBRAT E AUTORIT (Dr. Musli Vërbanit)

1. “Besimi në Zotin”
2. “Melaqet e Zotit”
3. “Besimi në Librat e Zotit”
4. “Pejgamberët e Zotit”
5. “Besimi në Ditën e Kijametit”
6. “Besimi në Kaderin e Zotit”
7. “Tregime nga jeta e Muhamedit a.s.”
8. “Fikhu i Namazit”
9. “Fikhu i Zekatit”
10. “Fikhu i Agjërimit”
11. “Fikhu i Haxhit”
12. Emërtoni fëmijët tuaj me emra të bukur
13. “Dëshmorët e 9 Prillit në Rakoc dhe Lagje të Re”
14. “Shkruaj, lexo dhe mëso shkronjat e Kur'anit
15. “Nata e dhëndërisë”
16. “Fadil Çaka – Komandant Sharri”
17. “Dita e vdekjes dhe e varrimit”
18. “(Pa)mundësia e përkthimit të Kur'anit”.

PËRKTHIMET NGA GJUHA ARABE

1. “Këshilltari fisnik për djem dhe vajza” (nga autori Muhamed Sajim)
2. “Islami dhe Politika” (nga autori Jusuf Kardavi)
3. “Mrekullitë numerike në Kur'anin Fisnik” (nga autori Abdurrezak Nufel)
4. “Për Kushtetutën Islame” (nga autori Dr. Muhamed Sejid Ahmed El Musejer)
5. “Kryesore në terminologjinë e Hadithit” (nga autori Abduhu Abas El-Velidi)
6. “Vlera e kohës” (nga autori Amër Halid)
7. “Vëllazëria muslimane” (nga autori Amër Halid)
8. “Vëllazëria në islam dhe zemra e shëndoshë” (nga autori Amër Halid)
9. “Pendimi” (nga autori Amër Halid)
10. “Pasojat e mëkateve” (nga autori Amër Halid)
11. “Shkurtimi i thonjve në dritën e sunetit dhe mjekësisë” (nga autorët Ebul Vefa Abdul Ahar dhe Jahja Nasir)

PËRMBAJTJA:

HYRJE	3
LËNDA E STUDIMIT	4
QËLLIMI I KËTIJ STUDIMI	5
ÇKA ËSHTË E RE NË KËTË STUDIM	6

KAPITULLI I PARË

SHKURTIMI I THONJVE NË DRITËN E SUNNETIT	9
KUPTIMI I SHKURTIMIT TË THONJVE	9
SHKURTIMI I THONJVE SIPAS SHERIATIT ISLAM	9
E PARA: PRERJA E THONJVE ËSHTË PREJ NATYRSHMËRISË	10
E DYTA: KOHËZGJATJA E MOSPRERJES SË THONJVE	12
E TRETA: PENGESAT E SHERIATIT NË RITJEN E THONJVE	13
PENGESAT E SHERIATIT ISLAM NË LIDHJE ME	
ZGJATIMIN E THONJVE	14
PERËNDIMIZIMI (VESTERNIZMI)	15
E KATËRTA: ETIKA E SHKURTIMIT TË THONJVE DHE	
SI E SHIKON ISLAMI BUKURINË	17

KAPITULLI I DYTË

SHKURTIMI I THONJVE NË DRITËN E MJEKËSISË	23
RRITJA E TEPËRT E THONJVE	24
PASOJAT TË CILAT SHKAKTOHEN PREJ	
RRITJES SË THONJVE	26
DËMET DHE PASOJAT NGA THONJTË E GJATË	29
E TRETA: PASOJAT TEK VETË THONJTË	
PËR SHKAK TË ZGJATIMIT TË TYRE	30
E KATËRTA: DËMET TË CILAT SHKAKTOHEN	
PËR SHKAK TË NGJYROSJES DHE LLAKIMIT TË THOIT	32
E PARA: SËMUNDJET E THONJVE	34
E DYTA: NDEZJA E LËKURËS	
PËR SHKAK TË ZBUKURIMIT TË THONJVE	35
REZULTAT I KËTIJ ANGAZHIMI	36
PËRFUNDIM	36
POROSI	36
LITERATURA E KONSULTUAR	37
FUSNOTAT	38
PËRMBAJTJA	44

Donator:
RESTORANT “MANI”

Pronar:
EKREM MANI

Përkthyesi falënderon donatorin, njëherit e lut Allahun që ta shpërblejë në këtë botë dhe në botën tjetër, dhe ta ngritë atë në shkallë të larta me pejgamberët, dëshmorët, të sinqertit dhe bamirësit.